

VENDIM
Nr. 117, datë 26.2.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I HYRJES SË QYTETIT TË SHKODRËS DHE BREGUT PERËNDIMOR TË LIQENIT TË SHKODRËS”,
BASHKIA SHKODËR**

(Ndryshuar me VKM nr. 148, datë 11.3.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”, Bashkia Shkodër.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “livadh”, “trual” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 405 986 166 (katërqind e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 405 986 166 (katërqind e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi

hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I HYRJES SË QYTETIT TË SHKODRËS DHE BREGUT PERËNDIMOR TË LIQENIT TË SHKODRËS”, BASHKIA SHKODËR

Nr. rendor	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM											Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasuritë etj.)
													Livadh			Truall			Ndërtesë social-ekonomike, vlerësuar me preventiv punimesh			Ndërtesë banimi			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1		LUANI-A sh.p.k.		Shkodër	8591	U-3	18/773	Truall	275	54	26				275	8511	2,340,525			-			2,340,525		
2		LUANI-A sh.p.k.		Shkodër	8591	U-3	18/771	Truall	360	54	28				360	8511	3,063,960			-			3,063,960		
3		LUANI-A sh.p.k.		Shkodër	8591	U-3	18/769	Truall	63	54	30				63	8511	536,193			-			536,193		
4		LUANI-A sh.p.k.		Shkodër	8591	U-3	18/764	Truall	102	51	224				102	8511	868,122			-			868,122		
5		LUANI-A sh.p.k.		Shkodër	8591	T-3	18/669	Truall+ndërtesë	3500	38	195				3500	8511	29,788,500	1975		52,111,766			81,900,266		
6		LUANI-A sh.p.k.		Shkodër	8591	T-3	18/731	Truall	1270	47	132				1270	8511	10,808,970			-			10,808,970		
7	IZET	BRAHIM	SHEQI	Shkodër	8591	T-3	18/714	Truall+ndërtesë	1350	24	18				1350	8511	11,489,850	937.3		28,871,529	233.93	58013	13,570,981	53,932,360	
8	GEZIM	FAIK	BALA	Shkodër	8591	S-4	18/85	Truall	700	15	36				700	8511	5,957,700			-			5,957,700		
9	GEZIM	FAIK	BALA	Shkodër	8591	S-4	18/86	Truall	700	15	37				700	8511	5,957,700			-			5,957,700		
10	MUHARREM		SHKJAU	Shkodër	8591	S-4	18/108	Truall + ndërtesë	1450	19	183				1450	8511	12,340,950	288		8,213,907			20,554,857		
11	GEZIM		ABAZI	Shkodër	8591	S-4	18/808	Truall	693	61	109				693	8511	5,898,123			-			5,898,123		
12	HASJE XHEMAL SADET YMER MIHAMED HAXHI ALI ISA EQEREM	IDRIZ BAJRAM BAJRAM BAJRAM BAJRAM BAJRAM BAJRAM BAJRAM	KADRIJA KADRIJA KADRIJA KADRIJA KADRIJA KADRIJA KADRIJA	Shkodër	8591	S-4	18/806	Truall	1882	61	113				1882	8511	16,017,702			-			16,017,702		
13	BILAL	FASLI	MEHAJ	Shkodër	8591	R-4	18/708/ND	Ndërtesë	80	40	15				80	8511	680,880	103.04		3,364,055			4,044,935		
14	PRANVERA	MUHAME R	MESHNUN I	Shkodër	8591	R-4	18/44	Truall+ndërtesë	240	17	212				240	8511	2,042,640	240		2,407,671			4,450,311		
15	TEREZINA	ZEF	GEHA	Shkodër	8591	Q-5	10/123	Truall	10500	37	127				10500	8511	89,365,500			-			89,365,500		
16	MERZUK		LUSHA	Shkodër	8591	S-4	18/695	Ndërtesë	360	37	144				0	8511	-	302		7,555,309			7,555,309		
17	FIRDEUS	FUAT	GOLEMI	Shkodër	8591	S-4	18/41ND	Ndërtesë	250	62	239				0	8511	-	248		5,629,025			5,629,025		
18	VIRGINIA	NIKOLL	CAFI	Shkodër	8591	R-4	18/700N	Ndërtesë	56	39	222				0	0	-	56		1,353,991			1,353,991	Leje nderitimi. Hipotekohet në favor të Shoqërisë “Nopi” sh.a.	
19	FERIT	JONUZ	ALLIA	Shkodër	8591	R-4	18/786	Truall+ndërtesë	245	57	109				245	8511	2,085,195	89		1,783,359			3,868,554		
20	FERIT	JONUZ	ALLIA	Shkodër	8591	R-4	18/787	Truall+ndërtesë	200	57	110				200	8511	1,702,200	59.2		1,807,689			3,509,889		
21 ¹	FATMIR		MUÇA	Shkodër	8591	R-4	18/71	Truall	11200	14	194				7770	8511	66,130,470			-			66,130,470	Shënim: Ka VKM shpronësimiti nr. 725/2020, për 3430 m². Sipërfaqja e kërkuar për shpronësim nuk mbivendoset me pjesën e shpronësimit me VKM-në e sipërcituar.	
22	KYDRETE FRIDA IDRIZ ARSHI	KASEM KASEM ELJAZ ELJAZ	LOPÇI ULQINAK U TROSHANI	Shkodër	8591	P-5	4/1122	Truall	765	61	105				488	8511	4,153,368			-			4,153,368		

¹ Të dhënat për shpronësim të numrit rendor 21 të tabelës bashkëlidhur vendimit zëvendësohen me VKM nr. 148, datë 11.3.2026 sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

	AGIM ANILA RITVAN NIRVANA MELIHA KYTBI EHADU BEHAR VALBONA VALDETE BAFTJAR SOKOL ARDITA MIMOZA	SHUAJP SHUAJP HASAN QAMIL RAGIP TAHIR RAGIP TAHIR RASIM RASIM RAGIP	TROSHANI TROSHANI TROSHANI 1 TROSHANI TROSHANI TROSHANI TROSHANI MERSINI PUKA VILA LESHA PUKA KRAJA KRAJA KRAJA																						
23	KYDRETE FRIDA IDRIZ ARSHI AGIM ANILA RITVAN NIRVANA MELIHA KYTBI EHADU BEHAR VALBONA VALDETE BAFTJAR SOKOL ARDITA MIMOZA	KASEM KASEM ELJAZ ELJAZ SHUAJP SHUAJP HASAN QAMIL RAGIP TAHIR RAGIP TAHIR RASIM RASIM RAGIP	LOPÇI ULQINAK U TROSHANI TROSHANI TROSHANI TROSHANI TROSHANI TROSHANI TROSHANI TROSHANI MERSINI PUKA VILA LESHA PUKA KRAJA KRAJA KRAJA	Shkoder	8591	P-5	4/1121	Truall	460	61	104			244	8511	2,076,684					-		2,076,684		
24	ABDYL ARDIAN BAHRI INDIRA MAKBULE MIMOZA MIRJAM NERMIN RIZA SHKENDI SHPRESA THABIT		Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi Rusi	Shkoder	8591	0-5, P-5	4/1027	Livadh	7000	54	33	3810	117	445,770							-		445,770		
25	MYFTINIA SHKODER			Shkoder	8591	O-5, P-5	4/157	Truall	4300	16	145			233	8511	1,983,063					-		1,983,063		
Vlera totale e shpronësimit												3810		445,770	32,112		275,288,295	4297.54		113,098,301			13,570,981	402,403,347	Shënim. Korrigjim hartografik, ka VKM shpronësimi nr. 725/2020, për 2428 m ² . Sipërfaqja e kërkuar për shpronësim nuk mbivendose t me sipërfaqen e shpronësimi t me VKM- n e sipërcaktuar.

TABELA E NDRYSHIMEVE DHE SHITESAVE NË LISTËN E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN ME VENDIMIN NR. 117, DATË 26.2.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘RIKUALIFIKIMI I HYRJES SË QYTETIT TË SHKODRËS DHE BREGUT PERËNDIMOR TË LIQENIT TË SHKODRËS’”
(Shtuar dhe ndryshuar me VKM nr. 148, datë 11.3.2026)

Nr. rendor	Pronari	Të dhëna kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)	Vlerësimet për shpronësim				Vlera totale (tekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
			Livadh	Truall	Ndërtesë social-ekonomike, vlerësuar me preventiv punimesh	Ndërtesë banimi		

[illegible]